

Kryengritjet e Tanzimatit në këngët popullore

(Gazeta “Ndryshe”, 21 qershor 2007)

Në gjysmën e parë të shek. XIX vendi ynë u përfshi nga një varg kryengritjesh kundër përpjekjeve të Portës së Lartë zbatimin e reformave centralizuese, që shiheshin nga shqiptarët si një përpjekje e saj për përjetësimin e sundimit otoman mbi Shqipërinë. Kryengritjet e Toskërisë, që kulmuan me kryengritjen e vitit 1847, janë pasqyruar gjerësisht në dokumentacionin e kohës si dhe në studimet historike shqiptare. Por tabloja e tyre do të ishte e paplotë, po të mbështetej vetëm në të dhënat e dokumenteve të shkruara, pasi nuk ka periudhë tjetër të historisë sonë që të ketë frymëzuar një krijimtari gojore kaq të pasur dhe të ruajtur kaq mirë sa periudha e Tanzimatit. Duke qenë një pasqyrim flakë për flakë i këtyre lëvizjeve, këto këngë përmbajnë të dhëna me vlerë që nuk i gjemë në dokumentet e shkruara. Për këtë arsye, vlera dokumentare e këngëve popullore kushtuar kësaj periudhe është e madhe. Prej këtyre këngëve mësojmë për fazat e zhvillimit të kryengritjes, që nga fillimi e derisa u shua me terror të egër, për prijësit e saj, për pjesëmarrjen e gjerë të popullsisë së Kurveleshit në të, për organizimin e veprimeve luftarake, për masat që mori Porta e Lartë për shuarjen e saj, për egërsinë me të cilën u shtyp, për numrin e forcave armike që u hodhën kundër kryengritësve si dhe për vendet ku u zhvilluan luftimet. Po nuk janë vetëm vlerat dokumentare. Këngët historike të kësaj periudhe shquhen edhe për frymën epike dhe vlerat e larta artistike të tyre.

Pjesën më të madhe të këtyre këngëve e përbëjnë ato kushtuar kryengritjes së vitit 1847. Po nuk mungojnë edhe këngët e kryengritjeve të Labërisë të viteve ‘30. I madh është edhe numri i këngëve që iu kushtuan çetave të kaçakëve, sidomos çetës së Bilbilenjve. Këngët e periudhës së Tanzimatit, që buruan nga shpirti poetik i popullit të Labërisë, u kënduan e u hodhën valle në dasma e gëzime në Kurvelesh dhe shërbyen si himne për djemtë e tij në luftëra e përpjekje me armiqtë. Duke u trashëguar nga brezi në brez, ato i kanë frymëzuar brezat e rinj të Kurveleshit me shpirtin e qëndresës ndaj pushtuesve të huaj dhe regjimeve antipopullore vendëse.

Shkaku kryesor pse fshatarët e Labërisë u ngritën në një revoltë që nuk ishte parë që nga shekulli XVI, ishte varfëria. “*Topjak e xhelepe s’ka,/ jemi botë fukara,/ jetojmë me lakëra,/ katër shtëpi me një ka*”, – i përgjigjen prerë fshatarët taksidarit, që u kërkonte havajetin, topjakun e xhelepin. Po nuk qenë vetëm taksat e shumta e të rënda që rrënonin ekonominë. Një rrezik tjetër që kërcënonte të asfiksonte ekonominë e familjeve të varfra ishte edhe thirrja nizam e redif e krahëve më të aftë për punë. Djaloshin nga Labëria thirrja për të shkuar nizam e bën të vajtojë i pikëlluar: “*Ç’erdh kuraja në Janinë,/ ku më gjet mua të zinë,.../ Të zezat dhënt’e mia/ do t’i hajë lukunia!*” Djemtë e shkretë i tmerronte mendimi se do t’i linin vendet e tyre të bukura, “*malet me trëndelinë*”, dhe do të dërgoheshin në vende shumë të largëta, “*te molla e kuqe*”, se mund të mbeteshin “*përtej urës së Qabesë*”, ku t’i hanin “*korbat e sorrat*”. I tmerronte mendimi se do t’u hiqnin veshjet shqiptare, se do t’u mungonin ushqimet me të cilat ishin rritur, se do t’u mësonin me zor një gjuhë që nuk e donin. Prandaj djali që nisat nizam, duke qarë hallin me shokët e tij, thotë: “*Shokë, do çvishet futsani,/ do na vishetë shallvari,/ ne nizamë do të vemi/ do hamë çorvë legeni.*” Atje djemtë do t’i nënshtroheshin një trajtimi të egër:

*O djema buzëburbuqe,
do bëjmë talim me supe,
do na flas’ bimbashi turçe,
neve turçe nukë dimë,
do na lozinë kamshinë,*

*ne turçe do të mësojmë
po shqipen të mos harrojmë.*

Kur autoritetet osmane u përpoqën ta nisnin zbatimin e reformave nga Kuçi, qindra burra të armatosur, nën udhëheqjen e Gjolekës, përzunë taksidarët e nëpunësit dhe në malet e Kurveleshit jehoi thirrja: “*Kurvelesh, krye të ngrini! Gra e burra armë vini! Nizam Turqis’ mo i jipni!*”. Thirrjes iu përgjigj gjithë Kurveleshi:

*Kuç, Kallarar e Bolenë,
treqint nivicjot’ levenë,
gjashtëdhjet’ golëm qenë,
Progonat derë më derë,
kërcyen në Tepelenë,
në Mekam e bënë benë:
“Djemtë tanë nizam s’venë
kush ta kthejë, le ta therë!*

Kur përpjekja për ndërmjetësim pranë sulltanit dështoi, atëherë që nga Stambolli, “*Çelua shkroi e dërgoi:/ “Ju Shqipëri nuri ç’thoi,/ do vini nizam a s’doi?/ se mua fjala s’ më shkoi.”* Muharrem Totua kishte kallëzuar tek sulltani krerët e kryengritjes dhe planet e tyre. Për këtë poshtërsi, populli i Kurveleshit i vuri atij damkën e tradhtisë. Populli e mallkon rëndë tradhtarin: “*Muharrem, t’u shoft’ oxhaku,/ ç’i bëre këtij sanxhaku?/ E prishe, t’u prishtë haku,/ t’u vulost’ me vulë gjaku!*”

Arsyet ekonomike qenë faktori kryesor që nxiti qëndresën masive të shqiptarëve ndaj reformave të Tanzimatit. Revolta ringjalli urrejtjen e thellë për “qenin turkoshak” dhe aspiratën për të shkundur zgjedhën shekullore osmane, ashtu siç kishin bërë fqinjët e shqiptarëve jo shumë kohë më parë. Për arritjen e këtij qëllimi Gjoleka shkriu jetën, siç thonë vargjet: “*U trete, Gjolek, u trete,/ sos u përpoqe për vete,/ po për gjithë vilajete*”. Gjoleka vetë e pohon se kjo luftë ka qëllime më të larta e më të qarta se luftërat e shkuara. Ajo “*s’ë për mua dhe për ti,/ po për gjithë Shqipëri.*” Kjo do të thotë se kryengritësit ishin të vetëdijshëm se luftonin “*për vatanin*”, për tërë kombin.

Kryengritja përhapet me shpejtësi nga Vlora në Berat dhe nga Mallakastra në Janinë. Prijësit e saj janë luftëtarë të njohur për trimërinë dhe përvojën e tyre të gjatë luftarake. Zenel Gjoleka kishte kaluar njëzet vjet më armë në dorë në luftëra kundër turqve; Rrapo Hekali, “*që thërrit sa tundej mali*”, ishte edhe ai një luftëtar tjetër me përvojë të gjatë luftarake; Tafil Buz “*mustaqeziu*” kishte qenë në krye të kryengritjeve të viteve ‘30; Hodo Nivica ishte një tjetër luftëtar me përvojë të gjatë. Me dhjetëra ishin prijësit e çetave të fshatrave që kishin përvojë luftërash e aftësi komanduese. Prandaj kryengritësit kishin besim të madh tek prijësit e tyre. Kjo duket nga karakterizimi që u bëhet atyre. Gjoleka dhe Tafili përshkruhen si “*trima të këqi,/ luftojnë me një Turqi,/ me një goxha Rumeli.*” Gjoleka, që mban veshje kombëtare, “*fustan mbi gju hajduçe*”, është bërë tmerrri i ushtarëve turq, të cilët i thonë komandantit të tyre: “*Mirjalla, tungjatjeta,/ me avash ato trum-beta,/ se shkojmë vendeve të egra./ Këtu kumandon Gjoleka,/ pa na pret e na bën feta,/ na var lisave në dega,/ për t’u pataksur jeta.*” Hodo Aliut poeti i këndon: “*O Hodo, Hodo Nivica,/ i lartë si Këndrvica,/ Hodo, kapedan i detit,/ i rri për karshi dovetit.*”

Porta e Lartë, duke e parë se po ndodhte ajo së cilës i ishte trembur prej kohësh dhe duke i njohur aftësitë komanduese të prijësve të kryengritjes dhe cilësitë luftarake të toskëve, mobilizoi gjithë forcat ushtarake të Rumelisë për shtypjen e saj. Forcat turke u hodhën mbi kryengritësit nga toka dhe nga deti. Tre batalione arrijnë nga deti dhe zbarkojnë “*në liman për nënë Vlorë,/ dy karav’ e tre pamporrë*”, / *ç’u nisë për në Mavrovë, /n’ urë të Brate u hodhë,/ Mesaplik ngritën taborrë.*” Kryengritësit e Kurveleshit të Poshtëm i sulmuan forcat turke në brigjet e Shushicës dhe u shkakuan humbje të mëdha: “*Kallarar, Kuç e Bolenë,/ ç’e mbëlodhë*

gurgulenë,/ në lum' e zunë dyfeknë.” Kënga na thotë se turqit, për t’u hakmarrë për humbjet, “*Kuç dhe Bolen' i dogjnë*” dhe pastaj iu drejtuan Grykës së Shurit për të dalë në Kurvelesh të Sipërm. Mirëpo aty “*me Gjolekën u përpoqnë*”. Gjoleka dhe Tafil Buzi u shkaktuan një disfatë të vërtetë forcave armike. Këtë përleshje na e përcjell kënga popullore, që thotë: “*Gryk’e Kuçe, gryk’ e keqe,/ një mij’ e treqind dyfeqe,/ i mban Gjoleka me vete.*” Nga ana e jugut, Hodo Nivica ndeshet me forcat turke në Palavli të Delvinës. Ai u jep zemër djemve të tij: “*O burra, t’u hidhemi,/ mos trëmbi se s’vritemi,/ me plumba s’ goditemi,/ me palla nuk pritemi.*” Me dhjetëra e dhjetëra luftëtarë kurveleshas u dalluan për bëmat e tyre. Në luftime morën pjesë edhe gratë, të cilat luftuan njëlloj si burrat. Poeti anonim, i këndon trimërisë së banorëve të kësaj krahine me vargjet: “*More djemt’ e Kurveleshit,/ me palla luftoni sheshit’./ Kurveleshi gur’ i thatë,/ me palla lëftojnë gratë.*”

Por kryengritësit nuk mund t’u bënin ballë fuqive ushtarake të gjysmës së Perandorisë. Fshatrat e Kurveleshit u dogjën, shumë nga krerët e kryengritjes u zunë dhe iu nënshtruan torturave çnjerëzore. Veziri urdhëron: “*Leskodukajt të m’i ziri,/ me duar prapa t’i lidhi,/ rrahë në kukë t’u viri,/ pisha në thonj t’u shtiri,/ në Stamboll brënda t’i shpiri!*” Kënga na dëshmon edhe fatin që patën një pjesë e krerëve të kryengritjes, që turqit “*mu te Rrapi seç i varë*”. Edhe Gjoleka e Hodo Nivica u zunë dhe u dërguan të luftonin në Mal të Zi, nga nuk u kthyen më. Gjendjen e rëndë në të cilën ra Labëria pas shtypjes së kryengritjes dhe zbatimit të reformave fiskale e të nizamit, nëna labe e vajton me vargjet prekëse:

E zeza shoqe ç’na gjet,/
mbeti Labëria shkret’.
Ku janë burrat, ç’i gjet?
U mbenë armët shkretë.
Djemt’ e tyre këtu s’janë,
ca redif’ e ca nizamë,’
ca vdekur e ca në hapsanë,
Labërinë shkret e lanë!

I gjithë ky prodhim gojor, megjithëse në formën e vjershave të shkurtra, përbën një thesar të rrallë, që, për nga vlerat poetike dhe informacioni historik, nuk e ka shokun në poezinë tonë popullore. Ai i ka të gjitha karakteristikat e një eposi. Ngjarjet që përshkruhen janë nga më heroiket dhe më dramatiket, të denja për një epos: përleshje të ashpra dhe ushtri të mëdha turke që shpartallohen në Delvinë, Gjirokastër, Dholanë, Mallakastër, Kurvelesh etj. Edhe protagonistët e këtyre ngjarjeve janë të denjë për heronjtë e një eposi: jeta e tyre e shkuar në luftëra me armikun, si Muji dhe Halili në eposin legjendar të Veriut në luftë me shqaun; bëmat e tyre në këto luftëra dhe fundi i tyre janë si ato të heronjve të legjendave. Po, ndryshe nga heronjtë e eposit të Veriut, që janë pjellë e imagjinatës, heronjtë e kryengritjeve të Tanzimatit janë persona historikë, paçka se herë-herë portretet e tyre dalin të poetizuar. Balil Nështa nuk e ka për gjë se lufton me “*të bir’ e Rumelisë*”. Çobo Golëmi lufton me aq tërbim, sa duket se “*ra tërmet e u tund vëndi*”; po nuk është vërtet tërmet, sqaron poeti popullor: “*Bën dyfek Çobo Golëmi*”. “*Çelo Picari furtunë*”, diplomati i Lidhjes, zihet “*me sulltan Mamunë*”, duke u ngrënë me të “*hundë për hundë*”. Rrapo Hekali, “*që thërret sa tundet mali*”, u fut tmerrin armiqve me zërin e tij. Gjoleka, hipur balashit, fluturon nëpër malet ku luftohet me armikun. Hodo Nivica, “*i lartë si Këndrevica*”, nuk u mund kurrë. Palla e argjendte e Leskodukajve, e trashëguar nga të parët, ishte aq e madhe dhe aq shumë shkëlqente, sa dukej për së largu. Vezullimi i saj u vret sytë njerëzve, që pyesin: “*Ç’është ajo që na shkon tutje?/ Pall’ e lar’ e Leskoduke,/ e mban Sadiku mbi supë*”. Birbil Shakua kishte ngritur më këmbë ushtritë e Rumelisë dhe të Janinës, që kërkonin ta hidhnin me çdo kusht në dorë. Dhe kur nëna sheh se armiqtë u kishin rrethuar shtëpinë, ai i thotë i qetë: “*Lëri, nënë, mos i nga,/ se do shkoj nëpër ta,/ t’i pres, t’i bëj lakëra.*”

Ashtu si heronjtë e eposeve, edhe këta trima nuk i pret shpata dhe me zor i zë plumbi. Gjoleka, pasi qëllloi kaftanazin, *“nxori pallën dhe shpëtoi,/ nëpër dyzet mijë shkoi”*; me Hodon e patën keq jo vetëm turqit, po *“dhe malazestë bezdisnë,/ bam ia bëjn’ e dot s’e vrisnë,/ plumbat mbi të s’ kolisnë”*; aq i fortë ish Bilbili, sa turqit nuk e mbanin dot të lidhur: *“Bilbil Shakua trim i rallë,/ ç’i këputi tre litarë”*. Edhe kur predhat e topave apo plumbat i zënë në trup, heronjtë tanë nuk merakosen për plagët, po për teshat e trupit, se kanë frikë mos u prishen. Balil Nivicës, nga gjylja që i ra tek këmbët, *“flaka i mori fustanë”*; Hodos plumbat e shumtë *“rrobat e shkreta ia grisnë”*.

Po, ndryshe nga heronjtë legjendarë, heronjtë e Tanzimatit janë të vdekshëm. Mirëpo, kur plumbat i zënë për vdekje, vdekja e tyre është si në legjenda. Gjoleka, i plagosur rëndë në pritë, nuk do të bjerë i gjallë në duart e malazezve dhe i thotë njërit prej trimave të tij: *“Shuaip, në të kam djalë,/ mos më lër në ta të gjallë,/ hiqma kokën me pallë.”* Hodua, bërë një me doriun e tij, fluturon mbi njerëzit e pritës, duke shpëtuar. Ky kalë, të cilit poeti i këndon: *“Të lumtë, o at i bardhë,/ që nxore Hodon të gjallë”*, e kishte nxjerrë këtë faqebardhë në sa e sa luftime. Aq i lidhur ishte me të zotin ky dori jo i zakonshëm, sa, kur vdiq Hodua, *“hingëllin i shkreti kalë,/ hingëllin e s’do të hajë,/ njëzet veta dot s’e mbajnë”*.

Në eposin historik të kryengritjeve të Tanzimatit e mbinatyrshtjës dhe e natyrshtjës pleksen ngushtë. Në këtë mënyrë, ai herë i afrohet eposit legjendar e herë i largohet atij. Në dallim nga heronjtë e eposeve legjendare, në eposin e Tanzimatit ngjarjet janë reale dhe heronjtë e tyre janë persona të vërtetë, me veti fizike reale. Çelua është *“arap i zi”*, Tafili *“një grusht njeri”*; të tjerë janë të pashëm: Sinan Malua *“çepeverdhë”*, Bilbil Leskua *“si ylli”*, Bilbil Shakua *“çepekrënde”*. Edhe trimëria dhe dashuria për vatanin, të përbashkëta për të gjithë, janë veti reale.

Këto elemente reale i japin vlera edhe më të mëdha këtij “eposi”, duke bërë që historiani t’i drejtohet atij kur dokumentet heshtin. Prej kësaj trashëgimie të pasur folklorike edhe studiuesi i letërsisë nxjerr lëndë të mjaftë sidomos për çështje të figuracionit poetik. Pikërisht, për këto vlera, botimi në një vëllim më vete i këtyre këngëve të shpërndara në botime të ndryshme do të përbente një ndihmesë jo vetëm për ruajtjen e trashëgimisë gojore, por edhe për letërsinë dhe historinë tonë kombëtare.

Rami Memushaj